

Lënda: Kthim përgjigje

Z. Gëzim Kurti

Në përgjigje të kërkesës tuaj, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të regjistruar me nr. 10116 prot, datë 04.12.2023, ju informojmë se:

Dokumentacioni i caktimit të përfitimit, për çdo përfitues nga skema e sigurimeve shoqërore administrohet nga struktura rajonale të sigurimeve dhe për këtë arsye kërkesën zyrtare, në lidhje me pagat të cilat ju janë konfirmuar dhe përfshirë në llogaritjen e pensionit duhet t'ia adresoni Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, e cila administron dosjen tuaj të pensionit.

Bashkëlidhur kësaj shkrese, po ju dërgojmë tabelën përmbledhëse të përqindjes së ndalimit të kontributeve, punëdhënës – punëmarrës dhe të pagave minimale e maksimale për efekt të pagesës së kontributeve, nga viti 1.10.1993 e në vazhdim, në të cilën janë të pasqyruara edhe të dhënat e kërkuara nga ju, për vitet 1996, 1997, 1998.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 14.9.2022 "Për indeksimin e pensioneve", masa e pensionit social në vitin 2022, ka qenë në vlerën 8,588 lekë.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.